

Cikli I programeve: “PERMES BIBLES”

Emisioni nr 1087 Zbulesa 16

HAPJA E VULËS SË PARË – KALORËSI MBI KALIN E BARDHË

Zoti Jezus Krisht merr librin me shtatë vula dhe hap vulën e parë.

“Pastaj pashë kur Qengji hapi të parën nga të shtatë vulat, dhe dëgjova një nga të katër qeniet e gjalla që thoshte si me zë bubullime: “Eja e shiko.”

Dhe unë pashë, dhe ja, një kalë i bardhë. Dhe ai që e kalëronte kishte një hark; dhe atij iu dha një kurorë, dhe ai doli jashtë si fitimtar dhe për të fituar.” [Zbl. 6:1-2].

Më poshtë gjendet përkthimi im për këto vargje:

Dhe pashë kur Qengji hapi një nga ato shtatë vula, e dëgjova një nga katër qeniet e gjalla që tha me një zë si bubullimë: “Nisu!”. Dhe pashë një kal të bardhë. Personi që e kalëronte kishte një hark, dhe atij iu dha një kurorë. Pastaj ai doli jashtë për të luftuar dhe për të fituar.

Krishti do t’i hapë të gjitha vulat, *ad seriatum*, një e nga një. Ai ka kontroll të plotë dhe cdo krijesë në qiell lëviz me urdhrin e Tij. Kështu katër kalorësit fillojnë të ecin me kuajt e tyre. Ai hap vulën dhe thotë “nisu”. Edhe pse në përkthimin e Mbretit Jakob të krijohet përshtypja sikur Gjoni i jepet një ftesë “Eja e shiko”, fraza “shiko” duhet shmangur dhe meqënëse urdhri vjen nga qielli, përkthimi i duhur është “Nisu”.

Sërish, deklarohet nga Gjoni se ai “pa” dhe “dëgjoi”. Pra, ne po shohim televizor.

Përpyekjet për të përcaktuar simbolin e kalorësit mbi kalin e bardhë kanë ngritur mendime të ndryshme. Interpretimi mbizotërues i komentuesve të ndrëshëm është se ai përfaqson Krishtin. Ata përdornin Psalmin 45 dhe Zbulesën 19 për të mbështetur mendimin e

tyre. Por, shumica e studiuesve bashkëkohorë të Biblës, që i përkasin shkollës së premilenializmit, thonë se kalorësi mbi kalin e bardhë është Antikrishti. Ky është mendimi i Skotit, Ajronsaide-t, Chafer, Valvoord, Udbrixh dhe Pentecost. Edhe unë mendoj si ata. Mendoj se do të ishte disi e vështirë për Zotin Jezus, Personin që në këtë moment po hapte vulën, të ndryshonte pozitën me shpejtësi, të hipte mbi një kal dhe të nisej për rrugë.

Për mua, kjo do të ishte një pozitë e papajtueshme dhe e pabesueshme. Personalisht, mbroj pikëpamjen që kalorësi mbi kalin e bardhë është Antikrishti, një imitim i Krishtit. Ai pretendon se është Krishti që po vjen.

Ne sot jemi drejtuar drejt një diktatori botëror. Sa më shumë që kalon koha, aq më i vërtetë bëhet ky fakt. Të gjitha kombet e botës janë të shqetësuara. Shkeljet e ligjit mbizotërojnë kudo dhe qeveritë nuk mund të kontrollojnë sic duhet. E gjitha kjo po përgatit rrugën për sundimin e një personi.

Antikrishti nuk shfaqet si bataksi. Përvec kësaj, engjëjt e satanit janë engjëj drite. Satani nuk ka brirë dhe as këmbë me thundra. Përkundrazi, kur të shfaqet do të jetë njeriu më tërheqës që ka parë bota. Ata do ta zgjedhin dhe bota do ta duartrokasë, sepse ka ardhur në emrin e tij. Por, kur të marrë sundimin për botën do të jetë një ditë e keqe.

Këto nuk janë përcartjet e një predikuesi, por dicka që e kanë thënë edhe njerëz të tjerë, që nuk e kanë shpallur me të madhe se ishin të krishterë. Profesor. A. J. Tojnbi, Drejtor i Studimeve në Institutin Mbretëror të Cështjeve Ndërkombëtare ka thënë:

“Duke i imponuar njerëzimit gjithnjë e më shumë armë vdekjeprurëse, dhe në të njëjtën kohë duke e bërë botën gjithnjë e më të ndërruar ekonomikisht, teknologjia e ka cuar njerëzimin në një shkallë të tillë dëshpërimi sa që tani jemi gati për të hyjnizuar cdo cezar të ri, i cili do të jetë në gjendje të sjellë paqe dhe unitet në botë.”

Kjo do të jetë platforma e Antikrishtit – paqe dhe unitet mbarëbotëror. Mendoj se kushdo që do të shfaqej në skenë tani dhe t’ia ofronte këtë botës, nuk do të pyeste fare nëse personi vinte nga qielli, apo nga ferri. Nuk mendoj se do të ishin të interesuar për këtë, sepse ata duan paqe me çfarëdo çmimi dhe në përpjekje për ta fituar atë paqe ne kemi harxhuar miliarda dollarë.

G. K. Cesterton, në kohën e tij vure re këtë: “Një nga paradokset e kësaj epoke është se është koha e lëvizjeve për paqen, por paqja vetë është ende larg.” Sot zhvillohen shumë biseda për paqen.

Para disa kohësh, në një nga edicionet e lajmeve dëgjova se një grua në Amerikë, i kishte lënë Kombeve të Bashkuara të gjithë pasurinë e saj prej 700 000 dollarësh duke thënë: “me shpresën e zjarrtë se ky kontribut shumë i vogël ndoshta mund të ndihmojë në sjelljen e paqes në tokë dhe vullnetin e mirë midis njerëzve.” Dua t’ju them se ajo i hodhi ato para në një vrimë miu, sepse paqja nuk mund të blihet me 700 000, apo me 700 milionë dollarë. Ne kemi harxhuar miliarda dollarë në mbarë botën për të siguruar paqe e si përfundim nuk kemi bërë asgjë.

Fondacioni Ford, një nga organizatat private botërore më të pasura, ka shpallur se në fund paratë e tyre do të përdoren për paqen botërore dhe qeverisje më të mirë, për kushtet e jetesës dhe edukimin – e megjithatë bota po bëhet gjithnjë e më keq.

Kur të vijë në pushtet, Antikrishti do të flasë për paqen dhe bota do të mendojë se po hyn në periudhën e Mijëvjecarit, kur në fakt po hyn në periudhën e Mundimit të Madh. Mundimi i Madh do të vijë si qengj, por do të dalë si luan. Premtimi i paqes është gënjeshtër më e madhe në botë.

Nën dritën e faktit që Krishti është Qengji në mes të fronit, Luani i fisit të Judës dhe Rrënja e Davidit që po drejton këto ngjarje nga qielli dhe po u jep urdhra kalorësve, arrijmë në përfundimin se kalorësi mbi kalin e bardhë nuk mund të jetë Krishti. Krishti identifikohet qartë tek Zbulesa 19-të, ndërsa këtu identiteti është disi i errët, gjë që të shtyn të mendosh se nuk është Krishti, por një imitues i Tij.

HAPJA E VULËS SË DYTË – KALORËSI MBI KALIN E KUQ

“Kur ai hapi vulën e dytë, dëgjova qenien e dytë të gjallë që thoshte: “Eja dhe shiko.”

Atëherë doli jashtë një kalë tjetër i kuq; dhe atij që e kalëronte iu dha të hiqte paqen nga dheu që njerëzit të vrasin njëri-tjetrin, dhe iu dha atij një shpatë e madhe.” [Zbl. 6:3-4].

Dhe kur hapi vulën e dytë, dëgjova qenien e dytë të gjallë që thoshte 'Nisu'.

Dhe një kal tjetër, i kuq zjarr doli. Dhe atij që e kalëronte iu dha të hiqte paqen nga dheu dhe që ata të vrisnin njëri-tjetrin në mënyrë mizore. Atij iu dha një shpatë e madhe.

Kalorësi i parë nuk mund të jetë Krishti, sepse Ai do të sjellë në tokë paqe të përhershme. Kjo është paqe jetëshkurtër. Menjëherë pasi ishte nisur kali i bardhë, për në tokë nisët kali i kuq i luftës. Paqja që solli në tokë kalorësi mbi kalin e bardhë ishte e përkohshme dhe e rreme. Antikrishti e përfaqson veten si sunduesi që do të sjellë paqen në botë, por nuk mund ta garantojë, sepse Zoti thotë: “Nuk ka paqe për të pabesët, thotë Perëndia im.” (Isa. 57:21). Dhe ai pasazh i Shkrimit është përmbushur plotësisht.

Miqtë e mi, ne jemi po aq larg nga paqja sac edhe kemi qenë edhe në kohërat e luftërave botërore.

Antikrishti do të jetë hipokrit. Ai nuk do të sjellë paqe, sepse ja ku del kali i kuq i luftës që nisët për në tokë sërish. Dhe kjo do të jetë një luftë e vërtetë botërore. Mos më thoni se është përmbushur, akoma jo. Kjo do të ndodhë në të ardhmen.

HAPJA E VULËS SË TRETË – KALORËSI MBI KALIN E ZI

“Dhe kur hapi vulën e tretë, dëgjova qenien e tretë të gjallë që thoshte: ‘Eja dhe shiko’. Dhe pashë dhe ja, një kalë i zi; dhe ai që e kalëronte kishte një peshore në dorën e tij.

Dhe dëgjova një zë në mes të katër qenieve të gjalla duke thënë: ‘Një kenik gruri për një denar, dhe dy kenikë elbi për një denar; dhe mos dëmto vajin, as verën.’ [Zbl. 6:5-6].

Dhe kur hapi vulën e tretë, dëgjova qenien e tretë të gjallë që thoshte “nisu”. Dhe pashë e vështrova një kal të zi dhe ai që e kalëronte kishte një peshore në dorë. Dhe dëgjova një zë në mes të katër qenieve të gjalla duke thënë; ‘një kenik gruri për një denar, dhe dy kenikë elbi për një denar; dhe mos dëmto as vajin dhe as verën.’

Gjoni sërish thotë: “dëgjova” dhe “pashë”. Ai do të jetë i sigurtë që e kemi kuptuar mirë këtë. Ngjyra e kalit të zi tregon vajtimin (shih Jer. 4:28; Mal. 3:14 “të veshur me rroba zie”) dhe në të njëjtën kohë simbolizon urinë. Tek Vajtimet 4:8-9 lexojmë: “Tani pamja e tyre

është më e zezë se terri. Nuk njihen dot më nëpër rrugë. Lëkura u bashkohet me kockat dhe u është tharë e bërë si dru. Të vrrarët nga shpata janë më mirë se ata që vdesin nga uria, sepse këta të fundit mbarojnë të rraskapitur nga mungesa e prodhimeve të fushës.”

Kali i zi përfaqson krizën e urisë mbarëbotërore që do të vijë në tokë. Gjithmonë pas luftës shfaqen mungesa në artikujt ushqimorë.

Historiani grek Hrodotus thotë se një “kenik” gruri ishte ushqimi ditor i një ushtari. Ndërsa një denar ishte paga ditore (shih Mt. 20:2). Prandaj, një burrë që punon nuk do të mund të ndihmojë familjen e tij në atë kohë.

Vaji dhe vera janë llukse që shijohen vetëm nga të pasurit. Vajrat korrespondojnë me gjërat e tualetit, si sapuni, pasta e dhëmbëve, kremrat, shampot e parfumërat që përdorim sot, pra këto janë lluksi i jetës. Vera korrespondon me pijet që gjenden me bollëk në kohën tonë. A nuk është interesant fakti që nuk do të ketë artikuj të mjaftueshëm ushqimor, elb të pamjaftueshëm për ushqim, megjithatë i mjaftueshëm për të bërë pije? Në atë kohë do të prodhohen pije, vetëm të pasurit.

Më lejoni të tregohem i qartë me ju. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, në pjesën më të madhe të kohës të pasurit mund të blinin mish. Ata mund të siguronin të gjithë lluksin për jetën. Një burrë i pasur më ka thënë se nuk i kishte mungur kurrë një copë e mirë bifteku sa herë që e kishte dashur. Por më kujtohen fare mirë thëniet e shumë njerëzve të thjeshtë, që vuanin për bukën e gojës. Edhe në të ardhmen gjërat nuk do të ndryshojnë. Të pasurit do të marrin gjithcka që duan, por të varfërit nuk do të mund të marrin asgjë. Kështu ka qenë gjithmonë. Më vjen për të qeshur kur dëgjoj këta djem të rinj, që tregojnë se si do t’i zgjidhin problemet e varfërisë. Më e pakta që mund të bëjnë është t’u gjejnë një punë të mirë të varfërve, por deri tani nuk kanë qenë aspak ndihmë për ta. Të varfërit nuk e kanë ngritur asnjëherë kokën. Pse? Sepse i Vetmi Njeri që mund t’i ndihmojë të varfërit është Jezus Krishti. Asnjë nga këta të rinj megjithë dëshirën e tyre të madhe nuk mund ta bëjë dot. Më vjen keq, që po i them këto fjalë, por dikush duhet të flasë kundër kësaj marrëzie.

Në këtë pjesë të librit të Zbulesës po flasim për të ardhmen. E vetmja arsye që e krahasova me kohën tonë është për të treguar se kjo nuk është e paarsyeshme. Ajo do të ndodhë.

Në vitin 1798, Rev. Tomas Maltus arriti në përfundimin se “rritja e popullsisë është shumë më e madhe sesa fuqia e tokës për të siguruar jetesën e njerëzve.” Parashikimi i tij pati pak peshë në kohën e tij. Në

1959 organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë në 77 vende u mbledh në Romë për të folur për “luftën kundër urisë dhe kequshqyerjes”. Në këtë mbledhje Tojnbi deklaroi: “Herët, ose vonë prodhimi i ushqimit do të mbarojë. Dhe atëherë, nëse popullsia do të vazhdojë të rritet, uria do të kryejë shfarosjen që është kryer në të shkuarën nga uria, murtaja dhe luftra të gjitha këto të marra së bashku. Sër Xhon Bojd Orr, dikur Gjeneral i përgjithshëm i organizatës për ushqim dhe bujqësi të Kombeve të Bashkuara, paralajmëroi: “Do ta përfundoj detyrën time duke i dhënë paralajmërimin e fundit botës. Nëse kjo çështje nuk zgjidhet bota do të jetë në kaos për 50 vitet e ardhshme. Kombet e botës janë cmendur.” Dikush ka raportuar: “Sot ka rreth 750 milion njerëz të uritur në vendet që kufizojnë sferën komuniste.” Ky numër po rritet, miq. Pas luftës gjithmonë vjen uria.

HAPJA E VULËS SË KATËRT – KALORËSI MBI KALIN E ZBEHTË

“Kur ai hapi vulën e katërt, dëgjova zërin e qenies së katërt të gjallë që thoshte: “Eja dhe shiko.”

Dhe unë pashë, dhe ja një kalë i zbehtë; dhe ai që e kalëronte emrin e kishte Vdekja, dhe Hadesi vinte pas tij. Dhe iu dha atyre pushtet përmbi një të katërtën e dheut, të vrasin me shpatë dhe me zi buke e me vdekje, dhe nëpërmjet bishave të dheut.”

[Zbl. 6:7-8].

Dhe kur hapi vulën e katërt, dëgjova zërin e qenies së katërt të gjallë që thoshte: “nisu”. Dhe pashë dhe një kalë të zbehtë; Ai që e kalëronte quhej Vdekja dhe Hadesi e ndiqte. Atyre iu dha pushtet përmbi një të katërtën e dheut, të vrasin me shpatë, me zi buke, me vdekje (murtajë) dhe nëpërmjet bishave të dheut.

Këtu shohim se murtaja do të bjerë mbi një të katërtën e popullsisë së tokës. Në atë kohë nuk do të ketë antibiotikë dhe penicilina të njaftueshme për ta ndaluar.

“Emrin e kishte Vdekja” Këtu personifikohet më shumë lufta sesa vdekja, edhe pse kalorësit iu dha emri vdekje. Në vdekjen fizike përfshihet më shumë se çfarë sheh syri, sepse qenia njerëzore është më shumë se dicka fizike, ndërsa vdekja më shumë se një ndërprerje e

aktivitetit njerëzor. Ndërkohë që vdekja merr trupin, Hadesi është vendi ku shkon shpirti i një njeriu të humbur (shih Luka 16:23).

Një përkthim fjalë për fjalë i Romakëve 5:14 thotë: “E megjithatë, vdekja u bë mbret që prej Adamit e deri tek Moisiu, madje edhe mbi ata që nuk kishin mëkatuar sipas modelit të mëkatit [shkeljes] të Adamit që është figura e Atij [Adamit] që do të vijë.”

“emrin e kishte Vdekja dhe Hadesi vinte pas tij”. Fjala Hades, fatkeqsisht ndonjëherë është përkthyer me fjalën ferr si tek Luka 16:23, ku flitet për të pasurin dhe Llazarin. Atje lexojmë: “Dhe, duke pasur mundime në ferr, i çoi sytë dhe pa nga larg Abrahamin dhe Llazarin në gji të tij.” Fjala *ferr* nuk është përkthimi i duhur në këtë varg; vargu në origjinal përmban fjalën Hades, dhe në fakt nuk i referohet aspak ferrit. Këtu bëhet fjalë për vdekjen fizike, ose për vendin ku shkon shpirti, ose për varrin ku vendoset trupi. Pra, me fjalë të tjera, ndërsa vdekja merr trupin, hadesi është vendi ku shkon fryma e një personi të humbur.

Kështu u shpreh Zoti Jezus në lidhje me këtë çështje.

Pali mishëron vdekjen tek Romakët 5:14, ashtu sic bën për të theksuar mëkatit në të njëjtën pjesë. Mëkati dhe vdekja hynë në botë në të njëjtën kohë. Vdekja është pasojë e mëkatit. Gjatë intervalit nga Adami tek Moisiu, njerëzit nuk kryen të njëjtin mëkat si Adami, madje as mëkatet e tyre nuk konsideroheshin shkelje e ligjit, sic u quajt mëkati i Adamit, sepse në atë kohë nuk ishin dhënë ende Dhjetë Urdhërimet. E megjithatë, ajo ishte një periudhë ku njerëzit mëkatuan dhe vdiqën. Mëkati i Adamit u bë mëkati i tyre, sepse ata vdiqën ashtu si Adami. Madje në kohën e Përmbajtjes vdiqën edhe bebe.

Në mënyrë të dukshme vdekja ka një kuptim të trefishtë gjithpërfshirës që ne normalisht nuk ia bashkangjijmë. Ne mendojmë se vdekja i referohet vetëm trupit. (1) Kjo është vdekja *fizike*, dhe i referohet vetëm trupit. Ajo vjen tek njeriu për shkak të mëkatit të Adamit. (2) Pastaj kemi vdekjen *shpirtërore*, që është një ndarje nga Perëndia dhe rrebelim ndaj Tij. Ne trashëgojmë një natyrë të vdekur prej Adamit. Kjo do të thotë se nuk kemi kapacitet për të kërkuar Zotin dhe as dëshirë për Të. (3) E fundit, është vdekja *e përjetshme*, që është një ndarje e përjetshme nga Perëndia. Nëse një person nuk është i shpenguar kjo vdekje është e pashmangshme. Kjo është vdekja e dytë që do të shohim në kapitullin 20, vargu 14.

Para se Adami të mëkatonte, Zoti i tha: “... sepse ditën që do të hash prej saj ke për të vdekur me siguri.” (Zan. 2:17). Adami jetoi *fizikisht* për më shumë se 900 vjet pas kësaj ngjarjeje, megjithatë ishte i vdekur

shpirtërisht ndaj Perëndisë. Ai u largua nga Zoti dhe nuk kishte më dëshirë të kishte miqësi me Perëndinë. Ai vdiq shpirtërisht dhe pas kësaj erdhi vdekja fizike. Kjo gjë kaloi në të gjithë familjen njerëzore. Gjithnjë e më shumë vdekja po e shkatërron njerëzimin. Shumë prej nesh sot mbështeten tek mjekësia moderne dhe zhvillimi i mahnitshëm i shkencës për të qëndruar gjallë. Në fakt, rraca njerëzore po degjenerohet gjithnjë e më shumë. Jeta njerëzore do të ishte shumë më e shkurtër nëse nuk do të ekzistonin pajisjet moderne që na mbajnë gjallë.

Adami deklarohet këtu si një tip i Krishtit. Vdekja mbetet në derën e Adamit si një përgjegjësi totale e tij. Sic e shihni, Zoti nuk e krijoi njeriun për të vdekur. Ky ishte një dënim që erdhi për shkak se Adami shkeli urdhrin e Zotit. Për shkak se Adami është kreu federal i racës sonë, shkelja e tij është shkelja jonë, dhe vdekja e tij është vdekja jonë. Krishti është kreu i një krijese të re dhe kjo krijesë e re ka jetë vetëm në Krishtin. Vetëm Ai mund t'i japë jetë. Ai është plotësisht përgjegjës për jetën dhe lumturinë e përjetshme të atyre që janë të Tijët.

Dr. Levis Sperry Cafer shpalli këtë deklaratë teologjike:

“Kështu vdekja shpirtërore vjen përmes një linje të pavazhdueshme në brezat e ardhshëm. Në kontrast me këtë, vdekja fizike merret menjëherë prej Adamit, sepse cdo person vdes në trup për shkak se ka një pjesë personale në mëkatin e parë të Adamit.”

Gjatë periudhës së Mundimit të Madh, vdekja do të kalërojë pa fre. Zoti Jezus tha: “Dhe, po të mos shkurtoheshin ato ditë, asnjë mish nuk do të shpëtonte; por për shkak të të zgjedhurve, ato ditë do të shkurtohen.” (Mt. 24:22). Në gjykimin para Fronit të Madh e të Bardhë vdekja do të shkatërrohet përfundimisht (shih Zbl. 20:14). Kjo konfirmohet nga Pali që shkruan: “Armiku i fundit që do të shkatërrohet është vdekja.” (1 Kor. 15:26). Gjoni e rishpalli atë tek Zbulesa 21:4: “Dhe Perëndia do të thajë çdo lot nga sytë e tyre; dhe vdekja nuk do të jetë më; as brengë, as klithma, as mundim, sepse gjërat e mëparshme shkuan.”

Shpata, zia e bukës, murtaja dhe bishat e dheut do të asgjesojnë një të katërtën e popullsisë së tokës. Zoti e kishte thënë këtë edhe nëpërmjet profetit Ezekiel: “Sepse kështu thotë Zoti, Zoti: "E njëjta gjë do të ndodhë kur të dërgoj kundër Jeruzalemit katër gjykatësit e mi të

tmerrshëm, shpatën, urinë, kafshët e egra dhe murtajën për të shfarosur njerëz dhe kafshë.” (Ezek. 14:21).

Kali i zbehtë përfaqson fatkeqësinë dhe murtajën që do të godasë tokën. Këtu përfshihet edhe mundësia e luftës bakteriologjike. Dr. Frank Holtman, shefi i departamentit bakteriologjik në Universitetin në Tenesisë ka thënë: “ndërkohë që një pjesë e madhe e popullsisë së qytetit mund të shkatërrohet nga një bombë atomike, lufta bakteriologjike mund të zhdukë shumë lehtë të gjithë popullsinë brenda javës.”

Ne pamë nisjen e katër kalorësve dhe kjo përputhet saktësisht me modelin që dha Zoti Jezus kur ishte në tokë. Tek Mateu 24:5-8, në Predikimin mbi mal, Ai tha: “Sepse shumë do të vijnë në emrin tim, duke thënë: "Unë jam Krishti" dhe do të mashtrojnë shumë njerëz. Atëherë do të dëgjoni të flitet për lufta dhe për ushtima luftrash. Ruhuni të mos shqetësoheni, sepse të gjitha këto duhet të ndodhin, por ende mbarimi nuk do të ketë ardhur. Do të ngrihet, pra, popull kundër populli dhe mbretëri kundër mbretërie. Do të ketë zi buke, murtajë dhe tërmete në vende të ndryshme. Por të gjitha këto gjëra do të jenë vetëm fillimi i dhembjeve të lindjes.” Kjo është hapja e periudhës së Mundimit të Madh.